


№. 36 prot
Shkoderi 20/06/18



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 2 Datë 13. 06. 2018

“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “DOMI TEC” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 42, nenit 51 dhe nenit 52, të ligjit nr. 6/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 111/2012 dt.15.11.2012 Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, të kontratës konçesionare të formës BOT (nr. 10332 Rep. Nr.3326 Kol, datë 09.09.2013 si dhe të kontratës shtesë të konçesionit (nr. 184 Rep. Nr. 65 Kol., datë 10.03.2017), për paisjen me leje të përdorimit të burimit ujqor të subjektit “DOMI TEC” SH.P.K, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujqor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin e lejes së subjektit “DOMI TEC sh.p.k.” me administratore Znj.Lindita DOMI, për përdorim të burimit ujqor **Përroi i Plepës** për prodhim energjie elektrike në fshatin Okshtun, Njësia Adm. Ostren, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti **HEC PLEPI** do të ketë këto të dhëna:

| | | | |
|---|-------------------------------------|------------------------------------|---------------------|
| Koordinatat e veprës së marrjes dega 1: | $X_1 - 44\ 43\ 838;$ | $Y_1 - 45\ 86\ 238.22;$ | $Z_1 - +1503.4\ m;$ |
| Koordinatat e veprës së marrjes dega 2: | $X_2 - 44\ 45\ 084.02;$ | $Y_2 - 45\ 85\ 799.94;$ | $Z_2 - +1322\ m;$ |
| Koordinatat e godinës së centrali: | $X - 44\ 45\ 952.34;$ | $Y - 45\ 85\ 197.59;$ | $Z - +1015\ m;$ |
| Koordinatat e pikës së shkarkimit: | $X - 44\ 45\ 952.34;$ | $Y - 45\ 85\ 197.59;$ | $Z - +1015\ m;$ |
| Prurja mesatare vjetore e burimit: | $Q_1\ mes/vjetor = 0.252\ m^3/sek;$ | $Q_2\ mes/vjetor = 0.14\ m^3/sek;$ | |
| Sasia e ujqit që kërkohet të përdoret: | $Q_1\ llog = 0,396\ m^3/sek;$ | $Q_2\ llog = 0,263\ m^3/sek;$ | |
| Prurja ekologjike: | $Q_{1ekol} = 0.048\ m^3/sek;$ | $Q_{2ekol} = 0.023\ m^3/sek;$ | |
| Prurja që shkarkohet: | $Q = 0.659\ m^3/sek.$ | | |

2-Leja e përdorimit të burimit ujqor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujq të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.



PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

